

Integrimi

Ç'është integrimi?
Ofertat e integritit
Azili në Zvicër

Ç'është integrimi?

Integrimi është kur njeriu ndihet mirë në Zvicër, kur të gjithë ndihen se janë pjesë e të njëjtës bashkësi, kur çdo njeri merr pjesë në të mirën e të gjithëve. Pak nga pak, çdo njeri duhet të marrë pjesë, sipas mundësive të tij, në jetën ekonomike, politike, kulturore dhe shoqërore. Për një integrim të mirë, respekti, ndihma e ndërsjellë dhe mundësitë e barabarta janë të rëndësishme.

Si ndodh integrimi?

Integrimi ndodh në jetën e përditshme: në shtëpi, në punë dhe gjatë kohës së lirë. Çdo njeri mund të lëvizë lirisht dhe të komunikojë me të tjerët. Njerëzit nga të gjitha vendet dhe të gjitha kulturat duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë, me respekt. Rregullat për një integrim të mirë të të huajve janë shkruar në nenin 4 të Ligjit federal mbi të huajt dhe integrimin (LEI).

Integrimi: një përgjegjësi e të gjithë shoqërisë

Integrimi ka të bëjë me të gjithë. Integrimi është për të mirën e të gjithëve. Shteti (Konfederata, kantonet dhe komunat) dhe shoqëria duhet të lehtësojnë mundësitë e barabarta për të gjithë. Duhet nxitur pjesëmarrja e të huajve në jetën publike.

Integrimi ndodh në radhë të parë në strukturat e zakonshme si:

- shkolla
- trajnimi
- puna
- dhe fusha e shëndetësisë

Ndonjëherë, duhen oferta integrimi për të ndihmuar të huajt të hyjnë në strukturat e zakonshme. Për shembull një klasë integrimi, me mësimë frëngjishteje dhe mësimë të tjera, për të mundur, më vonë, të hyjnë në një shkollë profesionale.

Politika e integritimit

Prej vitit 2014, Konfederata dhe kantonet krijojnë Programe kantonale të integritimit (PIC). Këto programe përmbajnë oferta për të huajt.

Programi PIC përmban fusha të ndryshme:

- Informacionet dhe këshillat
- Kurset e frëngjishtes
- Trajnimi dhe puna
- Fëmijëria e hershme
- "Të jetuarit së bashku"
- Lufta kundër diskriminimit dhe racizmit
- Përkthimi me gojë dhe me shkrim

Çdo kanton krijon programet e veta sipas nevojave të tij.

Që prej vitit 2019, ofertat e integritimit për njerëzit që vijnë nga azili bëjnë pjesë në këto programe (Agenda Intégration Suisse (AIS)).

Përveç PIC, Konfederata mbështet edhe projekte të tjera dhe programe kombëtare.

Në kantonin e Jura-së: 2 shërbimet kryesore për integritimin

- Zyra e integritimit të të huajve dhe e luftës kundër racizmit (BI)

Në kantonin e Jura-së, kjo zyrë zbaton politikën e integritimit të të huajve dhe të luftës kundër racizmit.

Kjo zyrë është pika e kontaktit midis popullatës, administratës, institucioneve dhe shoqatave.

Kjo zyrë bën pjesë në Shërbimin e aksionit shoqëror, nën përgjegjësinë e Departamentit të Punëve të Brendshme të kantonit të Jura-së.

- Shoqata Jurasiane e Pritjes së Migrantëve (AJAM)

AJAM pret personat që i takojnë sistemit të azilit (lejet B të refugjatit, F, N dhe S).

AJAM i shoqëron në jetën e tyre të re në kantonin e Jura-së.

Kjo shoqatë ndihmon personat:

- të marrin përkujdesje mjekësore
- të gjejnë një punë
- të strehohen
- dhe të integrohen në jetën shoqërore jurasiane.

Kantoni i Jura-së ia ka deleguar këtë punë AJAM-it.

AJAM kujdeset gjithashtu për Qendrën e Animacionit dhe Trajnimit për Gratë dhe Familjet (CAFF) dhe Shtëpinë Komunitare të Shëndetit (MdSC).

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/integrimi/lintegration-cest-quoi

Ofertat e integritimit

Ofertat e integritimit ndihmojnë të huajt të njohin më mirë strukturat e zakonshme dhe të mund të hyjnë më lehtë në to. Për shembull shkolla, trajnimi, puna dhe fusha e shëndetësisë. Kështu, të huajt mund të marrin pjesë më mirë në jetën e shoqërisë.

1. Informacionet dhe këshillat

Personat që mbërrin në kantonin e Jura-së marrin informacione dhe këshilla mbi, për shembull:

- jetën e përditëshme
- të drejtat dhe detyrat
- kurset e frëngjishtes
- mbështetjen për fëmijët e vegjël
- trajnimin
- punën
- mbrojtjen kundër racizmit.

Pas mbërritjes së tyre, personat janë të ftuar në një seancë të Mirëseardhjes. Komuna dhe kantoni u urojnë mirëseardhjen dhe u japin informacione mbi jetën në kanton dhe mbi shërbimet e dobishme.

Për më tepër informacione dhe këshilla mbi integrimin dhe luftën kundër racizmit, kontaktoni këtë Zyrë :

Zyra e Integritimit të të huajve dhe luftës kundër racizmit

Faubourg des Capucins 20 – 2800 Delémont

E-mail: secr.bi@jura.ch

Tel. 032 420 51 12

Të hënë dhe të enjte nga ora 8:30 në orën 12:00 dhe nga ora 13:30 në orën 16:30

Të premten nga ora 8:30 në orën 12:00 dhe nga ora 13:30 në orën 16:30.

AJAM propozon oferta informimi dhe këshillimi posaçërisht për personat që vijnë nga azili.

Qendra e dokumentimit për të gjithë

Në Bibliotekën kantonale jurasiane në Porrentruy, një Qendër e dokumentimit është e hapur për të gjithë, si për publikun, ashtu dhe për profesionistët. Aty mund të gjejsh informacione mbi temat e integritimit dhe të racizmit.

2. Kurset e frëngjishtes

Mësimi i frëngjishtes është i rëndësishëm për t'u kuptuar mirë dhe për të gjetur një punë ose një trajnim. Kjo ndihmon gjithashtu për të zgjidhur problemet e përditshme.

Kurset e frëngjishtes në kantonin e Jura-së

Programi COMUNICA propozon kurse frëngjishteje për të huajt, nga niveli Fillestar (A1) deri në nivelin e Përpëruar (B2). Këto kurse nuk kushtojnë shtrenjtë. Në programin COMUNICA, ka gjithashtu kurse për personat që nuk e njohin alfabetin tonë ose që kanë vështirësi në të lexuar ose në të shkruar: kurse shkrimi dhe leximi.

Disa komuna mbulojnë një pjesë të tarifës së regjistrimit.

Qendra e animacionit dhe trajnimit për gratë dhe familjet (CAFF) propozon kurse frëngjishteje për gratë, me një shërbim të mbajtjes aty të fëmijëve. Këto kurse nuk kushtojnë shtrenjtë.

Në krahinë ka dhe kurse të tjera të frëngjishtes.

AJAM propozon gjithashtu kurse gjuhësh posaçërisht për personat që vijnë nga azili

Cili është niveli i frëngjishtes?

Për të njohur nivelin e frëngjishtes së një personi, shpesh përdoret "Kuatridhe Evropian i referencës për gjuhët – Të nxënës, Të mësuarit, Vlerësimi (KEPR)".

Ky kuadër shkon nga niveli A1 (fillestar) në nivelin C2 (zotërim i përsosur). Për të ndjekur një trajnim profesional, shpesh duhet pasur një nivel B1 ose B2.

Testi "fide" kontrollon nivelin e frëngjishtes për jetën e përditshme në Zvicër. Ai teston nivelin e gjuhës me gojë (të folurit) dhe të gjuhës së shkruar. Rezultatet jepen në një "Pasaportë të gjuhëve". Kjo pasaportë mund të përdoret për të kërkuar punë, për të aplikuar për leje qëndrimi ose vendbanimi, ose për të kërkuar shtetësinë zvicerane.

3. Trajnimi dhe puna

Shumë njerëz vijnë të jetojnë në kantonin e Jura-së për të punuar. Për më tepër, 5% e të huajve vijnë në kantonin e Jura-së për të ndjekur një formim profesional.

Por shpesh, për të huajt është e vështirë të integrohen në botën e punës. Është e vështirë për arsye të ndryshme: procedurat administrative janë të ndërlikuara, shkollat dhe formimet e vendit të tyre nuk janë të njëjta me ato në Zvicër, përvojat dhe diplomat e vendit të tyre nuk njihen në Zvicër, personat nuk e flasin aq mirë frëngjishten, ata nuk kanë shumë miq dhe të njohur. Ndonjëherë, personat janë viktimë të diskriminimit ose padrejtësisë kur kërkojnë një punë ose në vendin e tyre të punës.

Ndihma për të kërkuar punë

Zyra rajonale e punësimit (ORP) ndihmon personat për të kërkuar një punë .

Në Zyrën e integritetit të të huajve dhe të luftës kundër racizmit janë në dispozicion dy broshura. Ja titujt:

- “Të kërkuar punë në kantonin e Jura-së” (informacione dhe mjete)
- “Të gjithë të barabartë ndaj punësimit. Udhërrëfyes i praktikave të mira për parandalimin e racizmit dhe diskriminimeve në botën e punës” (sidomos për punëdhënësit)

Ndihma për të gjetur dhe filluar një formim

Programet PréFOR dhe PAI + janë për të rinjtë nga 16 në 25 vjeç, të ardhur në Zvicër.

Këto programe i ndihmojnë këta të rinj të hyjnë, më vonë, në një formim profesional.

Shërbimi i formimit pas arsimit të detyrueshëm (pas shkollës së detyrueshme) i ndihmon të rinjtë dhe të rriturit të gjejnë një formim profesional .

AJAM propozon gjithashtu ndihmë për të gjetur një formim posaçërisht për personat që vijnë nga azili.

4. Fëmijëria e hershme (nga 0 në 4 vjeç)

Vitet e para të jetës janë të rëndësishme për zhvillimin e fëmijës. Gjatë kësaj kohe, fëmija mëson shumë gjëra. Është e rëndësishme që fëmijës t'i jepen baza të qëndrueshme, sidomos për ecurinë shkollore të tij.

Qendra e Animacioni dhe Trajnimit për Gratë dhe Familjet (CAFF) propozon atelie për prindërit dhe fëmijët.

Në këto atelie, flitet për rolin e prindit. Gjithashtu flitet për këtë temë: “Si të përgatitet fëmija për ta filluar mirë shkollën”.

“Petits:pas” është një program i propozuar nga Familles2000.

Ky program mbështet zhvillimin e fëmijëve. Ai i ndihmon të integrohen në shoqëri.

Përmes lojërave dhe veprimtarive me prindërit e tyre, fëmijët mësojnë të flasin, të lëvizin, të kenë shokë, të kontrollojnë emocionet e tyre, etj.

“Bain de livres” organizon veprimtari rreth librave dhe historive në më shumë se 80 gjuhë.

Libra dhe lojëra mbi Të Jetuarit-bashkë: ekzistojnë libra dhe lojëra për t'u folur fëmijëve për kulturat e ndryshme dhe të Jetuarit-bashkë. Disa libra dhe lojëra janë në dispozicion në Bibliotekën kantonale jurasiane në Porrentruy.

Frëngjishtja dhe fëmijët

Fëmijët që vijnë nga një gjuhë e huaj duhet të hyjnë në kontakt me fëmijë frëngjishtfolës sa më shpejt që të jetë e mundur. Është e rëndësishme që ata ta mësojnë frëngjishten para se të shkojnë në shkollë. Çerdhet, kopshtet e fëmijëve ose ofertat e posaçme për prindërit dhe fëmijët janë shumë të përshtatshme për këtë. Prindërit duhet të përdorin shumë edhe gjuhën e tyre me fëmijët. Edhe kjo është e rëndësishme.

Për shembull: t'u flasin shumë fëmijëve, t'i dëgjojnë, t'u tregojnë histori në gjuhën e tyre.

Fëmijët që shkojnë në shkollë mund të ndjekin gjithashtu kurse në gjuhën e tyre. Këto kurse quhen: kurse të gjuhës dhe të kulturës së origjinës (kurse LCO). Këto kurse organizohen në përgjithësi nga ambasada ose konsullata ose një shoqatë e vendit të origjinës.

Shkollat japin të gjitha informacionet në lidhje me kurset LCO.

5. "Të Jetuarit-bashkë"

Të gjithë duhet të ndihen mirë në kantonin tonë. Çdo person është pjesë e shoqërisë dhe sjell kompetencat e tij për të mirën e të gjithëve. Çdo person mund të angazhohet në jetën e përditshme, në komunën e tij, lagjen e tij ose me fqinjët.

Shoqatat, grupet e të huajve dhe bashkësitë fetare janë të rëndësishme për këtë. Është gjithashtu mundësia për të bërë vullnetarizëm.

Doni të krijoni projekte për të mbështetur për të mbështetur "Të Jetuarit bashkë"?

Informacione të dobishme dhe këshilla të dobishme do t'i në këtë adresë:

Zyra e Integritetit të të huajve dhe luftës kundër racizmit

Faubourg des Capucins 20

2800 Delémont

E-mail: secr.bi@jura.ch

Tel. 032 420 51 12

Të hënë dhe të enjte nga ora 8:30 në orën 12:00 dhe nga ora 13:30 në orën 16:30

Të premten nga ora 8:30 në orën 12:00 dhe nga ora 13:30 në orën 16:30.

Për gratë

Qendra e Animacionit dhe Trajnimit për Gratë dhe Familjet (CAFF) propozon atelie dhe veprimtari për gratë emigrante. Këto atelie japin mundësinë për të folur frëngjisht dhe për të njohur njerëz të rinj.

Për të gjithë (burra dhe gra)

LARC, e administruar nga Caritas Jura, është një vend i hapur për të gjithë. Ky vend propozon veprimtari për t'u takuar dhe për të njohur njerëz të rinj.

Zyra e integritetit të të huajve dhe luftës kundër racizmit organizon ndonjëherë evente si tryeza të rrumbullakëta ose ekspozita mbi tema të lidhura me integritetin ose racizmin.

6. Lufta kundër diskriminimit dhe racizmit

Një person trajtohet në mënyrë të padrejtë? Respektohet më pak se të tjerët për shkak:

- të origjinës së tij
- të gjinisë së tij
- të moshës së tij
- të gjuhës së tij
- të gjendjes së tij shoqërore
- të mënyrës së tij të jetesës
- të fesë së tij, vlerave të tij, ose opinioneve të tij politike
- ose për shkak të një paftësie fizike, mendore ose psikike?

Atëherë ky person është viktimë e diskriminimit.

Thuhet gjithashtu: ky person diskriminohet.

Në Kushtetutën e Zvicrës, shkruhet: askush nuk duhet të diskriminohet.

Neni 261bis i Kodit penal ndëshkon aktet publike të diskriminimit.

Megjithatë, diskriminimi dhe racizmi gjenden në shumë fusha të jetës.

Për shembull në punë, në kërkimin e një banese ose në marrëdhëniet me fqinjët.

Kjo mund të jetë në formën e fjalëve lënduese, akteve të dhunës ose dhe të padrejtësive.

Fatkeqësisht kjo ndodh shpesh në mënyrë të fshehur. Nuk duket.

Jeni viktimë e diskriminimit ose racizmit?

Ose keni parë akte diskriminimi ose racizmi?

Atëherë kontaktoni këtë Zyrë:

Zyra e Integritetit të huajve dhe luftës kundër racizmit

Faubourg des Capucins 20 – 2800 Delémont

E-mail: secr.bi@jura.ch

Tel. 032 420 51 12

Të hënë dhe të enjte nga ora 8:30 në orën 12:00 dhe nga ora 13:30 në orën 16:30

Të premten nga ora 8:30 në orën 12:00 dhe nga ora 13:30 në orën 16:30.

Atje do të gjeni njerëz që ju dëgjojnë, informacione dhe këshilla.

Kjo Zyrë shënon dhe regjistron të gjitha rastet e diskriminimit në kantonin e Jura-së.

Dëshironi të angazhoheni kundër racizmit?

Kjo Zyrë ju këshillon dhe ju mbështet në projektet tuaja kundër racizmit.

7. Përkthimi me gojë dhe me shkrim

Kur mbërrini në Zvicër, ju nuk e flisni ende frëngjishten, ose nuk e kuptoni mirë. Por shumë shpesh, është e rëndësishme të kuptoheni mirë.

Për situata të thjeshta, ju mund t'u kërkon miqve, të afërmve ose personave të bashkësisë suaj, t'ju ndihmojnë për të përkthyer.

Por për biseda të rëndësishme, ose private (për shembull, me një mjek, në shkollë ose për dokumente zyrtare), është më mirë t'i drejtoheni një përkthyesi profesionist.

Shërbimi "se comprendre" i Caritas Suisse propozon përkthyes profesionistë.

Këta janë përkthyes të komunitetit. Disa vijnë nga vendi juaj. Ata e flasin gjuhën tuaj dhe e njohin edhe kulturën tuaj. Ata punojnë personalisht, nëpërmjet telefonit ose videos. Këta përkthyes mund t'ju ndihmojnë gjithashtu për procedura të posaçme.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/integrimi/les-offres-dintegration

Azili në Zvicër

Ishit në rrezik në vendin tuaj? Dhe jeni larguar nga vendi juaj për të kërkuar azil? Në Zvicër, ligji për azilin (LAsi) përcakton rregullat e azilit. Sekretariati i shtetit për migracionin (SEM) studion me vëmendje çdo kërkesë. Ky ligj thotë: çdo person në rrezik në vendin e tij për shkak të origjinës, fesë, kombësisë, grupit të tij shoqëror ose opinioneve të tij politike, ka të drejtë të kërkojë azil në një vend tjetër.

Çfarë është azili?

Në mbarë botën, ka njerëz që duhet të largohen nga vendi i tyre dhe të kërkojnë ndihmë në një vend tjetër. Disa njerëz janë në rrezik në vendin e tyre për arsyet e përshkruara më sipër.

Njerëz të tjerë duhet të largohen për shkak të luftës.

Zvicra u jep azil (lejen B të refugjatit) personave që janë njohur si refugjatë. Kjo do të thotë: personat që janë personalisht të kërcënuar dhe në rrezik për jetën.

Zvicra u jep mbrojtje për një kohë të kufizuar (leje e përkohshme F ose S) personave që nuk janë njohur si refugjatë, por që kanë nevojë të mbrohen.

Politika e azilit në Zvicër

SEM (Sekretariati i Shtetit për migracionin) vendos kush mund të jetë refugjat dhe të marrë azil në Zvicër. Për këtë, SEM analizon çdo kërkesë. Ai ndjek rregullat e përcaktuara në ligjin mbi azilin (LAsi), në Konventën e Gjenevës dhe sipas marrëveshjeve të Dublinit.

Një refugjat është një person që është në rrezik në vendin e tij për shkak: të origjinës, fesë, shtetësisë, të grupit të tij shoqëror ose opinioneve të tij politike.

Njihen si refugjatë, personat që:

- janë të kërcënuar dhe në rrezik të madh për shkak të arsyeve të mëposhtme:
- nuk mbrohen nga vendi i tyre
- nuk mund të strehohen në një pjesë tjetër të vendit të tyre

Sekretariati i Shtetit për migracionin (SEM) e studion me vëmendje çdo kërkesë azili.

Ligji zviceran mbi azilin shpjegon se si zhvillohet procedura e azilit. Ai shpjegon gjithashtu shumë elemente mbi jetën në Zvicër si strehimi, lejet e qëndrimit, bashkimi familjar, qasja në punë, ndihma sociale, sigurimet shëndetësore dhe integrimi.

Zvicra ndjek gjithashtu rregullat e marrëveshjes së Dublinit. Këto rregulla përcaktojnë cili vend duhet të shqyrtojë kërkesën për azil. Në përgjithësi, ky është vendi ku personi ka bërë kërkesën e tij të parë.

Shoqata Jurasiane e Pritjes së Emigrantëve (AJAM)

AJAM pret personat që vijnë nga azili (lejet N, F, S dhe B të refugjatit).

AJAM i shoqëron në jetën e tyre të re në kantonin e Jura-së.

Kjo shoqatë ndihmon personat:

- të marrin përkujdesje mjekësore
- të gjejnë një punë
- të gjejnë një banesë
- dhe të integrohen në jetën shoqërore jurasiane.

Kantoni i Jura-së ia ka deleguar këtë punë AJAM-it.

AJAM kujdeset gjithashtu për Qendrën e Animacionit dhe Trajnimit për Gratë dhe Familjet (CAFF) dhe Shtëpinë Komunitare të Shëndetit (MdSC).

Integrimi i personave që vijnë nga azili (lejet N, F, S dhe B të refugjatit)

Integrimi i këtyre personave bëhet në 3 etapa:

1. Pritja e parë: mbërritja dhe përcaktimi i nevojave

Personat që mbërrijnë në kantonin e Jura-së shkojnë fillimisht në një qendër kolektive. Punonjësit socialë shohin dhe vlerësojnë nevojat e çdo personi. Së bashku, ata bëjnë një plan integrimi, me objektiva personale.

Kjo etapë zgjat 2 javë.

2. Shoqërizimi: njohja e jetës në Zvicër

Kjo etapë i ndihmon personat të integrohen në jetën jurasiane (të zhvillojnë veprimtari dhe të kenë shokë). Edukatorët socialë dhe punonjësit socialë ndihmojnë personat të ndërtojnë jetën e tyre të re në Zvicër.

Kjo etapë zgjat nga 6 muaj deri në 1 vit e gjysmë.

3. Integrimi profesional: gjetja e një pune

Specialistë të punës propozojnë ndihmë për gjetjen e një pune dhe për ta mbajtur atë. Këta specialistë quhen: "job coach". Ata ndihmojnë gjithashtu personat t'u njihen diplomat e tyre të huaja ose të ndjekin një formim profesional.

Kjo etapë zgjat disa vite, deri në përfundim të shoqërimit nga AJAM.

Sa kohë zgjat shoqërimi nga AJAM?

Në përgjithësi, AJAM shoqëron personat deri sa ata të gjejnë një punë dhe të jenë të pavarur.

Ofertat e integrimit të AJAM, për personat që vijnë nga azili.

Ka oferta integrimi për të rriturit dhe për të rinjtë.

1. Oferta për të rriturit

Ja ofertat për të rriturit:

- Atelietë e informimit

Pas mbërritjes së tyre në Zvicër, personat marrin pjesë në shumë atelie informimi.

Këto atelie janë të detyrueshme.

Këto atelie zhvillohen në frëngjisht dhe në gjuhën e origjinës. Ato trajtojnë tema të ndryshme si: shëndeti, jeta në Jura, puna, strehimi.

- Kurset e frëngjishtes

Kurse të ndryshme të frëngjishtes propozohen për të gjithë personat: të rinj dhe më të vjetër, me ose pa familje, me apo pa punë.

Këto mësimet janë të niveleve të ndryshme: nga Fillestar (A1) në të Përparuar (B2).

2. Oferta për të rinjtë

Deri në 15 vjeç, fëmijët shkojnë në shkollën e komunës së tyre.

Në përgjithësi, duke nisur nga 16 vjeç, të rinjtë ndjekin një formim profesional.

Por të rinjtë e huaj mund të ndjekin, në fillim, një formim të posaçëm për të përmirësuar frëngjishten dhe kompetenca të tjera (për shembull matematikën).

Ja ofertat për të rinjtë:

- Bravo

Për të rinjtë nga 16 deri 25 vjeç, që nuk kanë formim dhe që fillojnë të mësojnë frëngjishten.

Ky program i ndihmon të rinjtë të arrijnë në nivelin A1 në frëngjisht. Ai propozon gjithashtu bazat në matematikë dhe në informatikë.

- PréFor (për para-formim)

Për të rinjtë nga 16 në 25 vjeç me nivelin A1 në frëngjisht.

Ky program i ndihmon këta të rinj të hyjnë në një formim profesional.

Ai mëson frëngjishten deri në nivelin B2.

Ai sjell gjithashtu kompetenca në matematikë dhe në informatikë.

- PAI+ (për para-mësimi i integritit)

Për të rinjtë nga 16 në 25 vjeç me nivelin B1 në frëngjisht.

Ky program i ndihmon këta të rinj të hyjnë në botën profesionale. Ai i përgatit të rinjtë të ndjekin një praktikë (AFP ose CFC).

Ky program zgjat 1 vit.

Lejet e ndryshme në fushën e azilit

Që prej mbërritjes së tij në Zvicër, një person do ta ndryshojë lejen disa herë.

Kjo varet nga etapat dhe rezultatet e kërkesës së tij për azil.

Leja që personi merr (N, F ose B refugjati) është shenja e statusit të tij juridik.

Statusi juridik tregon se si njihet personi në sistemin e azilit në Zvicër.

Statuset juridike (ose lejet) e ndryshme nuk japin të njëjtat të drejta në jetën e personit.

Për shembull, sipas lejes, kjo është e ndryshme për:

- të drejtën e bashkimit familjar (të sjellë familjen e tij në Zvicër)
- të drejtën për të punuar
- të drejtën për ndihmë sociale
- të drejtën për të udhëtuar

Ja një tabelë që shpjegon lejet e ndryshme sipas statusit juridik

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/integrimi/lasile-en-suisse